



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 164, datë 21.12.2012**

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT STANDARD TË AKT-VLERËSIMIT TË DËMEVE  
NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13 dhe nenit 14, paragrafi 23, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 89 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Formatit Standard të Akt-Vlerësimit të Dëmeve në Sigurime, sipas formës dhe përmbajtjes të materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**